



---

**VENDIM**  
**Nr.79 Datë 03.11.2010**

**PËR**  
**NDRYSHIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE TË SHOQËRISË AMAL SH.P.K ME SERI PV03K,**  
**NR.09 LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE**  
**TE ERE-S NR.18, DT.16.10.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, pikës 2.3 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, neneve 13, 14 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.11.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “AMAL” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.09, Seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.18, dt.16.10.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatohet se:**

1. Kërkesa që ka paraqitur shoqëria “AMAL” sh.p.k, në ERE për modifikimin e liçensës është konform ligjit dhe në respektim të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”.
2. Proçesi civil për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë vendim, ka si palë ndërgjyqëse personat fizikë Z. Agim Elezi dhe Znj. Luljeta Hysolli. Shoqëria “AMAL” sh.p.k subjekt i proçedurës për modifikimin e liçensës, është palë ndërgjyqëse në këtë proçes gjyqësor.

3. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është ankimuar në Gjykatën e Apelit, pra nuk ka një Vendim të Formës së Prerë lidhur me posedimin e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “AMAL” sh.p.k.
4. Akti Administrativ i Modifikimit të Liçensës lidhet direkt me rritjen e kapacitetit të asetit të liçensuar (Hec Xhyre) dhe nuk ka pasoja të drejtpërdrejta mbi ortakët e shoqërisë “AMAL” sh.p.k.
5. Proçesi gjyqësor i ndodhur mes palëve dhe Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk e prek thelbin e çështjes për Modifikimin e Liçensës, të Hec Xhyre, sipas proçedurave dhe akteve nenligjore të miratuara në ERE.
6. Aseti (Hec Xhyre), dhënë me konçesion të formës ROT, sipas VKM-së nr. 486, datë 13.07.2003, apo liçensa me Nr. 9, Seria PV03K, nuk janë objekt gjykimi.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Ndryshimin e liçensës Nr.09, Seria PV03K, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.18, dt.16.10.2003, për shoqërinë “AMAL” sh.p.k.
2. Fuqia e Instaluar e Hec “Xhyre“ nga 250 kW të bëhet 570 kW.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe te reflektoje ndryshimet ne liçense.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**

**A**